

ARC sh.p.k

Pasqyrat Financiare individuale më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

FAQE

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE:

PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR **3**

PASQYRA INDIVIDUALE E PERFORMANCËS **4**

PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL **5**

PASQYRA INDIVIDUALE E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE **6**

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE INDIVIDUALE **7-26**

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e Shoqërisë ARC sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë **ARC sh.p.k** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2023, pasqyrën individuale të performancës, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare individuale. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare individuale në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SKKP, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

16 korrik 2024

**forv/s
mazars**
Irena Hoxha
Emin Dureku, Str. Binjaket Build.,
Krr. 1013, Tirana, Albania
NUI: K32123006W

Irena Hoxha (Pulo)
Auditues Ligjor

**Pasqyra individuale e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2023**

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	6,517,432	14,880,194
Huadhënie afatshkurtër	5	10,415,500	24,815,410
Huadhënie afatshkurtër ndaj palëve të lidhura	6	53,974,400	38,053,600
Llogari të arkëtueshme tregtare	7	86,338,648	27,732,147
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	8	16,959,791	7,759,045
Të tjera llogari të arkëtueshme	9	9,073,486	16,053,615
Inventarë	10	44,611,554	112,605,808
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	11	31,864,276	30,951,640
Totali i aktiveve afatshkurtra		259,755,087	272,851,459
Aktivët afatgjatë			
Investime në pjesëmarrje	12	36,432,458	25,691,591
Huadhënie afatgjatë	13	31,599,540	26,901,165
Aktive afatgjatë materiale	14	51,177,931	58,996,530
Aktive afatgjatë jomateriale	15	249,016	283,888
Totali i aktiveve afatgjatë		119,458,945	111,873,174
Totali i aktiveve		379,214,032	384,724,633
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	16	74,281,190	38,070,652
Llogari të pagueshme tregtare	17	23,960,174	31,507,494
Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare	18	3,065,953	3,140,872
Detyrime tatimore	19	4,845,108	6,244,870
Garanci të marra	20	143,147	157,409
Detyrime ndaj palëve të lidhura	21	145,472,730	172,534,228
Të tjera detyrime	22	1,660,981	1,570,449
Totali i detyrimeve afatshkurtra		253,429,283	253,225,974
Detyrime afatgjatë			
Qira financiare	18	7,352,816	11,442,529
Totali i detyrimeve afatgjatë		7,352,816	11,442,529
Totali i detyrimeve		260,782,099	264,668,503
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Fitime të mbartura		119,956,130	116,650,510
Fitimi i ushtrimit		(1,624,197)	3,305,620
Totali i kapitalit	23	118,431,933	120,056,130
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		379,214,032	384,724,633

Pasqyrat financiare individuale duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Pasqyra individuale e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	24	230,165,643	360,166,184
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	25	(9,815,439)	(3,868,069)
Total të ardhura		220,350,204	356,298,115
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(195,273,160)	(318,488,994)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	26	(174,099,839)	(285,834,137)
2) Të tjera shpenzime	27	(21,173,321)	(32,654,857)
Shpenzime të personelit	28	(13,584,558)	(22,288,195)
1) Paga dhe shpërblime		(11,791,737)	(19,561,379)
Shpenzime të sigurimeve		(1,792,821)	(2,726,816)
2) shoqërore/shëndetësore			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	29	(7,336,307)	(6,989,039)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	30	(1,722,637)	(2,110,630)
Shpenzime financiare	31	(3,948,477)	(1,713,474)
Shpenzime interesi dhe			
1) shpenzime të ngjashme		(3,948,477)	(2,980,661)
2) Shpenzime të tjera financiare		-	1,267,187
Fitimi/humbja para tatimit		(1,514,935)	4,707,783
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(109,262)	(1,402,163)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi			
1) fitimin		(109,262)	(1,402,163)
Fitimi/humbja e vitit		(1,624,197)	3,305,620
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(1,624,197)	3,305,620

Pasqyrat financiare individuale duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Pasqyra individuale e ndryshimeve në Kapital**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2022	100,000	83,289,323	33,361,187	116,750,510
Transferim në fitime të mbartura	-	33,361,187	(33,361,187)	-
Fitim I vitit	-	-	3,305,620	3,305,620
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	100,000	116,650,510	3,305,620	120,056,130
Transferim në fitime të mbartura	-	3,305,620	(3,305,620)	-
Fitim I vitit	-	-	(1,624,197)	(1,624,197)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023	100,000	119,956,130	(1,624,197)	118,431,933

Pasqyrat financiare individuale duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë aprovuar nga administratori i **ARC sh.pk** më ___/___2024 dhe janë firmosur si më poshtë:

Zenel Hysenbegasi
Administrator

Pasqyra individuale e Fluksit të Mjeteve Monetare**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		(1,624,197)	3,305,620
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		7,336,307	6,989,039
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:			
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		613,108	1,768,736
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(60,827,118)	3,671,434
Rënie/(rritje) në huadhënie afatshkurtër		(6,219,265)	(4,737,135)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(35,932,310)	(2,466,494)
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra		(912,636)	18,480,262
Rritje/(rënie) në inventar		67,994,254	16,601,391
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(29,571,857)	43,612,853
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(95,944)	(32,323,662)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		(10,740,867)	(2,893,541)
Dividentë të arkëtuara			
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(10,836,811)	(35,217,203)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Ripagim/ të hyrat neto nga huatë		36,210,538	(23,493,378)
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		(4,164,632)	8,352,139
Dividendë të paguar		-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		32,045,906	(15,141,239)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		(8,362,762)	(6,745,589)
Mjetet monetare në fillim të periudhës		14,880,194	21,625,783
Mjetet monetare në fund të periudhës	4	6,517,432	14,880,194

Pasqyrat financiare individuale duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

1. Informacion i përgjithshëm

ARC sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me NUIS K81728025F, në përputhje me ligjin 9901 datë 19.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe nga statuti i saj. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është shërbime logjistike, organizim i udhëtimeve individuale dhe kolektive për stafe profesionale, rezervime, shërbime guide. Masterplane-studime rajonale dhe urbanistike.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në rrugën "Themistokli Gërmenji", Ndërtesa nr 1.
Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lek dhe zotërohet nga ortakutë në vetëm Z. Besnik Leskaj.

Në 31 dhjetor 2023 shoqëria ka 4 punonjës. (2022: 20 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare individuale

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKKP) dhe ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare individuale janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2023	2022
Euro/LEK	103.88	114.23
USD/ LEK	93.94	107.05

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matur me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2023 dhe 2022 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20 %
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë.

Shoqëria ka qira operative dhe financiare.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2023 është 15% (2022: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Mjete monetare ne banke	6,455,234	8,228,326
Ne Leke	586,290	6,850,476
Ne monedhe	5,868,944	1,377,850
Mjete monetare ne arke	62,198	6,651,868
Ne Leke	62,198	6,612,708
Ne monedhe	-	39,160
	6,517,432	14,880,194

5. Huadhënie afatshkurtër

Huadhënia afatshkurtër më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Huadhënie M&P I	10,388,000	24,787,910
Huadhënie ASG	27,500	27,500
	10,415,500	24,815,410

6. Hua afatshkurtër ndaj palëve të lidhura

Hua afatshkurtër ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Huadhënie Landways D.o.o	46,746,000	30,842,100
Huadhënie GBI	6,694,000	7,211,500
Huadhënie Blessed Investment	534,400	-
	53,974,400	38,053,600

7. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Klientë EUR	19,939,028	22,186,313
Klientë ALL	66,399,620	5,545,834
	86,338,648	27,732,147

8. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të arkëtueshme tregtare Abkons	12,032,694	6,580,815
Te arkëtueshme nga GBI International	308,406	132,435
Te arkëtueshme nga GBI shpk	-	20,561
TE arkëtueshme nga AFI	69,500	76,535
Të arkëtueshme nga Blessed Investment	9,500	9,500
Të arkëtueshme nga Landways d.o.o	2,337,892	939,199
Të arkëtueshme nga Albrail	2,201,799	-
	16,959,791	7,759,045

9. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Tatim fitimi i arkëtueshëm	6,508,899	5,044,379
TVSH e arkëtueshme	15,357	2,242,749
TVSH Leasing	1,353,261	1,802,549
Garanci të dhena	1,195,969	1,059,131
Të tjera të arkëtueshme	-	5,904,807
	9,073,486	16,053,615

10. Inventarë

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Mallra	21,937,250	87,078,408
Parapagime per mallra	22,674,304	25,527,400
	44,611,554	112,605,808

11. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Parapagim/Garanci per Kumtel Dayanikli Tuketim	27,076,909	30,855,685
Shpenzime te shtyra dhe parapagime te tjera	4,787,367	95,955
	31,864,276	30,951,640

12. Investime në pjesëmarrje

Investimet në pjesëmarrje detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
16.85% Aksone ne kompanine Albrail	20,295,000	22,798,050
50% Aksone ne kompanine GBI	5,920	5,920
35% ne kompanine Amor Bistro	35,000	35,000
50% Aksone ne kompanine Landways Croatia	2,852,500	2,852,500
100% Aksone ne kompanine ARC	121	121
100% Aksone ne kompanine Renew shpk	13,155,600	-
Aksione 50% GBI UZBEKISTAN	88,317	-
	36,432,458	25,691,591

13. Huadhenie afatgjatë

Huadheniet afatgjata detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Huadhenie K. Shehu	10,388,000	11,423,000
Huadhenie GBI International HUB	17,347,960	15,078,360
Huadhenie Amar Bistro Bar shpk	3,863,580	399,805
	31,599,540	26,901,165

14. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Punë në ambiente të marra me qera	Mjete transporti	Parapagime per Asete	Totali
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 1 janar 2022	17,470,600	1,476,280	12,468,398	51,254,706	-	82,669,984
Shtesa	22,205	8,333	-	10,153,154	22,139,970	32,323,662
Pakesime	-	-	-	(5,131,683)	-	(5,131,683)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	17,492,805	1,484,613	12,468,398	56,276,177	22,139,970	109,861,963
Shtesa	95,944	-	-	-	-	95,944
Pakesime	-	-	-	(2,634,074)	-	(2,634,074)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	17,588,749	1,484,613	12,468,398	53,642,103	22,139,970	107,323,833
<i>Amortizimi i Akumuluar</i>						
Gjendja më 1 janar 2022	11,142,672	818,319	6,203,360	29,121,655	-	47,286,006
Amortizimi i vitit	1,329,327	1,906	1,365,585	4,245,556	-	6,942,374
Pakesime	-	-	-	(3,362,947)	-	(3,362,947)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	12,471,999	820,225	7,568,945	30,004,264	-	50,865,433
Amortizimi i vitit	1,061,964	1,608	1,088,737	5,149,126	-	7,301,435
Pakesime	-	-	-	(2,020,966)	-	(2,020,966)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	13,533,963	821,833	8,657,682	33,132,424	-	56,145,902
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2022	5,020,806	664,388	4,899,453	26,271,913	22,139,970	58,996,530
Gjendja më 31 dhjetor 2023	4,054,786	662,780	3,810,716	20,509,679	22,139,970	51,177,931

15. Aktive afatgjata Jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 detajohen si më poshtë:

Kosto	AAJM
Gjendja më 1 janar 2022	449,647
Shtesa	-
Pakesime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	449,647
Shtesa	-
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	449,647
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja më 1 janar 2022	119,094
Amortizimi i vitit	46,665
Gjendja më 31 dhjetor 2022	165,759
Amortizimi i vitit	34,872
Gjendja më 31 dhjetor 2023	200,631
Vlera neto kontabël	
Gjendja më 31 dhjetor 2022	283,888
Gjendja më 31 dhjetor 2023	249,016

16. Hua afatshkurtra

Huaja afatshkurtër më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Overdraft Tirana Bank	74,281,190	38,070,652
	74,281,190	38,070,652

17. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Furnitorë në lekë	20,965,638	26,565,106
Furnitorë në monedhë	2,994,536	4,942,388
	23,960,174	31,507,494

18. Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare

Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Pjesa afatshkurtër e qirase financiare	3,065,953	3,140,872
Pjesa afatgjatë e qirase financiare	7,352,816	11,442,529
	10,418,769	14,583,401

19. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	136,668	386,115
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	75,460	153,922
Tatim në burim	-	120,434
TVSH për t'u paguar	4,632,980	3,511,578
Të tjera tatime për tu paguar	-	2,072,821
	4,845,108	6,244,870

20. Garanci të marra

Garancitë e marra më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Garanci të marra	143,147	157,409
	143,147	157,409

21. Detyrime ndaj palëve të lidhura

Detyrimet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Huamarrje Blessed Investment	-	29,265,100
Detyrime për dividend ndaj Besnik Leskaj	138,172,134	140,498,434
Detyrime për investime në pjesëmarrje	4,495,836	2,770,694
Huamarrje Ikons	2,804,760	-
	145,472,730	172,534,228

22. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Paga të pagueshme	1,585,530	1,570,449
Të tjera detyrime	75,451	-
	1,660,981	1,570,449

23. Kapitali

Kapitali i nënshkruar nuk ka patur ndryshime dhe mbetet në total prej 100,000 lekë.

Fitimi i mbartur më 31 dhjetor 2023 është 119,956,130 lekë. (31 dhjetor 2022: 116,650,510 lekë).

24. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Te ardhura nga shitja e mallrave	174,854,086	281,603,168
Të ardhura nga shërbimet e logjistikës	17,698,374	20,641,137
Të ardhura nga qiraja	2,771,572	3,758,253
Të ardhura shërbime konsulence	34,841,293	54,163,626
	230,165,325	360,166,184

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në

Qarkullim i tatueshëm	236,158,664
Zbriten të ardhura nga interesat paraqitur neto tek të ardhura financiare	(1,672,131)
Zbriten të ardhura të tjera financiare	(13,523,220)
Zbriten VKN nga shitja e aktiveve paraqitur neto	(613,109)
Shuma e qarkullimit e korrigjuar	220,350,204
Sipas Kontabilitetit	220,350,204
Diferenca	-

25. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë të ardhurat të tjera të realizuara gjatë aktivitetit të shfrytëzimit si dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga shitja e aktiveve (neto)	51,774	(1,263,486)
Të ardhura nga kembimet valutore aktiviteti operativ (neto)	(13,523,220)	(2,887,519)
Të ardhura të tjera	3,656,325	282,936
	(9,815,121)	(3,868,069)

Dalja jashtë përdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga shitja e AAM	664,883	505,249
Shpenzime nga shitja e AAM	(613,109)	(1,768,737)
Rezultati Neto nga shitja e AAM	51,774	(1,263,488)

26. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara.

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Kosto e mallrave të shitura	163,525,177	256,276,652
Shërbim logjistike	3,017,462	3,523,123
Karburant për logjistikën	7,557,200	8,468,400
Shërbim kontrate	-	17,565,962
	174,099,839	285,834,137

27. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Mirëmbajtje dhe riparime	4,455,168	3,481,523
Personel jashtë njësisë	421,438	3,176,481
Transferime, udhëtime, dieta	4,065,093	7,462,202
Shpenzime qiraje	5,733,782	8,225,331
Shërbime bankare	531,681	1,136,444
Shërbime Konsulence	1,074,651	3,506,684
Taksa të ndryshme	1,613,439	2,331,317
Shpenzime pritje percejllje	1,481,314	2,249,688
Shpenzime të tjera	1,796,755	1,085,187
	21,173,321	32,654,857

28. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime paga	11,791,737	19,561,379
Shpenzime per sigurime shoqerore	1,792,821	2,726,816
	13,584,558	22,288,195

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2023 është 4 punonjës. (2022: 20 punonjës)

29. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime amortizimi	7,336,307	6,989,039
	7,336,307	6,989,039

30. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Gjoha të ndryshme	26,039	110,198
Shpenzime te tjera	1,696,598	1,466,134
Dhurata	-	534,298
	1,722,637	2,110,630

31. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime për interesa	5,620,608	4,052,557
Të ardhura nga interesat	(1,672,131)	(1,071,896)
Te ardhura te tjera financiare	-	(1,267,187)
	3,948,477	1,713,474

32. Shpenzime tatim fitimit

Shpenzimi I tatim fitimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Fitimi para tatimit	(1,514,935)	4,707,783
Total shpenzime të panjohura	2,243,350	4,639,967
Shpenzime për dhurata	-	445,842
Penalitete, gjoha e dëmshpërblime	26,039	110,198
Vlera kontabël e AAM të shitura	-	1,263,485
Pritje percjellje	381,187	1,169,189
Sponsorizime	-	-
Taksa makinash cash	-	88,456
Shpenzime të tjera	1,836,124	1,562,796
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	728,415	9,347,750
Tatim fitimi @15%	(109,262)	(1,402,163)
	(1,624,197)	3,305,620

33. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023		31 dhjetor 2022	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Abkons shpk	12,032,694	-	6,580,815	-
IKONS shpk	-	2,804,760	-	-
Albanian Financial Institution	69,500	10,418,769	76,535	14,583,401
Albrail	2,201,799	-	-	-
Besnik Leskaj	-	138,172,134	-	140,498,434
Blessed Investment shpk	543,900	-	9,500	29,265,100
GBI shpk	6,694,000	-	7,232,061	-
GBI International	308,406	5,364	132,435	5,580
Landwyas d.o.o	49,083,892	2,412,768	31,781,299	2,730,000
ARC Kosova	-	104	-	114
Amor Bistro	-	-	-	35,000
Renew	-	2,077,600	-	-
	70,934,191	155,891,499	45,812,645	187,117,629

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2023		Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Abkons shpk	48,881,141	-	56,470,201	67,879
Ikons shpk	-	-	1,694,348	-
Albanian Financial Institution	726,901	3,838,893	609,991	2,764,679
BGP Southeast Europe shpk	-	-	363,000	-
GBI shpk	-	69,740	-	67,290
GBI International	187,971	-	132,435	-
Albrail	1,821,660	-	-	-
Blessed Investment shpk	1,366,596	-	104,834	-
Landwyas d.o.o	1,483,791	-	939,199	-
Matrix Konstuksion	-	-	-	199,274
	54,468,060	3,908,633	60,314,008	3,099,122

34. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2023 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme

35. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.